

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën në organet e administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), si dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17) Ministria e Arsimit dhe Shkencës caktoi Programin mësimor për **Arsim qytetar** për klasën VIII në arsimin fillor nëntëvjeçar.



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAMI
MËSIMOR

ARSIMI QYTETAR

Klasa VIII

Shkup, Qershor 2018

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

1. HYRJE

Në planin mësimor për arsimin fillor nëntëvjeçar, lënda mësimore *Arsimi qytetar* mësohet në periudhën e tretë të zhvillimit me status të lëndës së detyrueshme në klasën VIII dhe IX me nga një orë në javë, përkatësisht 36 orë në vit.

Duke pasur parasysh se lënda mësimore *Arsimi qytetar* mësohet në periudhën përfundimtare të arsimit fillor, në programet mësimore janë dhënë qëllimet zhvilluese për periudhën, në bazë të cilave konkretizohen qëllimet dhe përmbajtjet në çdo klasë.

Programi mësimor për *Arsim qytetar* është përgatitur me rezultate të qarta nga mësimnxënia. *Arsimi qytetar* në Republikën e Maqedonisë është përqëndruar ndaj zhvillimit të kompetencave të cilat kanë të bëjnë në gjithçka që pritet të dijnë nxënësit, të kuptojnë ose të mund të bëjnë dhe të pranojnë sistemin e vlerave të nevojshme për funksionimin si qytetar demokratik dhe aktiv. Të mësuarit e arsimit qytetar do të kontribuojë që nxënësit të angazhohen për zhvillimin e bashkësisë dhe të bëhen individë të kompletuar e të aftë në përzgjedhje për zhvillimin individual në shoqërinë bashkëkohore.

Programet e reja mësimore nga lënda e arsimit qytetar i reflektojnë ndryshimet në periudhat e mësimin të arsimit qytetar në Evropë dhe botë. Janë të përqendruara ndaj aftësisë të nxënësve për pjesëmarrje aktive të jetës në shkollë dhe zhvillimin e interesit dhe kompetencës për inkuadrimitin në proceset e sjelljes së vendimeve për bashkësinë. Metodatat të cilat do të përdoren në mësimin e arsimit qytetar duhet të kontribuojnë në zhvillimin e individit dhe vlerave bazë të njeriut, lirisë individuale, integritetit, dinjitetit dhe të drejtave të barabarza dhe për krijimin e kushteve për përfundimin e ndjenjës të së drejtës, tolerancës dhe përgjegjësisë, si dhe për përgatitjen e nxënësve për jetë të përgjegjshme në shoqëri demokratike qytetare.

Me programin mësimor janë paraparë mundësitë për punë të individualizuar dhe grupe të nxënësve e cila kontribuon për mendim të pavarur dhe kritik dhe aplikimi i njohurive të fituara, të kuptuarit, shkathësitë, qëndrimet, interesat, vlerat dhe sjellje qytetare në aktivitetet e më shumë çështjeve nga lëmi i arsimit qytetar. Natyra e lëndës mësimore kërkon respektimin e parimeve të mësimin intetektiv bashkëkohor, një punë grupe e menduar mirë e nxënësve në mësim që të përkrahë risia e secilit nxënës gjatë përfundimit të përmbajtjeve dhe aktiviteteve hulumtuese me ndjekje të vazhdueshme ndaj të arriturave të secilit nxënës nga mësimdhënësi.

2. QËLLIMET E LËNDËS PËR PERIU DHËN ZHVILLUESE (VIII-IX)

Nxënësi/nxënësj:

- t'i njohë dhe t'i identifikojë nocionet kryesore që kanë të bëjnë me shoqërinë qytetare;
- të respektojë dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut si vlera të bazuara në besimin e përgjithshëm se çdo person është po aq i rëndësishëm, të denjë për respekt dhe i përkasin liritë dhe të drejtat e njëjta;
- të vlerësojë demokracinë, drejtësinë, barazinë dhe ligjshmëritë si parime mbi të cilat funksionojnë shoqëritë bashkëkohore;
- t'i vlerësojë dallimet dhe llojllojshmëritë kulturore, pluralizmin e pikëpamjeve dhe sjelljet e tjerëve;
- për të zhvilluar hapjen dhe ndjeshmërinë ndaj dallimeve kulturore, besimeve, pikëpamjeve të botës dhe sjelljes së të tjerëve,
- të zhvillojë ndërgjegjen qytetare, ndjenjën e përkatësisë ndaj bashkësisë, ndërgjegjen për njerëzit tjerë në bashkësi dhe ndikimin e veprimeve individuale ndaj atyre njerëzve, solidaritetit dhe ndjenjën e përgjegjësisë qytetare ndaj;
- për të treguar përgjegjësinë për veprimet dhe vendimet e tyre nëpërmjet veprimit moral, veprimit të ndërgjegjshëm dhe përgjegjësisë për pasojat e procedurës;
- të besojë në aftësitë personale për ndërmarrjen e aksionit në arritjen e qëllimeve të caktuara;
- të zhvillojë shkathtësi për mendimin kritik dhe analitik, përkatësisht të analizojë në mënyrë sistematike dhe logjike, të vlerësojë dhe të gjykojë në bazë të argumenteve;
- të tregojë empati ndaj të tjerëve për t'i kuptuar mendimet, besimet dhe ndjenjat e njerëzve tjerë dhe ta sheh botën nga perspektiva e tyre;
- të njohë bashkëpunimin e interesit të përgjithshëm dhe publik në shoqërinë qytetare, duke përfshirë jetesën në një mjedis të shëndetshëm dhe zhvillim të qëndrueshëm;
- të bashkëpunojë me të tjerët në aktivitete të përbashkëta, detyra dhe ngjarje dhe t'i nxisë në bashkëpunim për arritjen e qëllimeve të përbashkëta;
- t'i zgjidhë konfliktet në mënyrë paqësore duke drejtuar anët e konfliktit në zgjidhje optimale dhe konstruktive që janë të pranueshme për të gjithë;
- të nxitet ndaj njohjes dhe kuptimit të vetvetës, e cila përfshinë dituri dhe kuptim kritik të mendimeve personale, besimit, ndjenjës dhe motiveve, si dhe në kontekst të përkatsisë personale kulturore dhe perspektivës më të gjerë shoqërore;
- të praktikojë komunikim konstruktiv dhe efektiv dhe interaksion me të tjerët;
- të sendërtojë njohuri për botën dhe të kuptojë botën në lëmi të ndryshme, duke përfshirë: ekonominë, religjionin, mediat, historinë, kulturën, të drejtat e njeriut, politikën, të drejtën;
- të demonstrojë mjetet demokratike për participimin e të gjitha niveleve dhe të merr pjesëmarrje aktive si individ, anëtar i grupeve ose si pjesë e shoqërisë;

- të njeh perspektivën evropiane dhe ndërkombëtare në aspekte të ndryshme;
- t'i njeh vlerat e përbashkëta evropiane dhe përfitimet nga integrimet në organizatat ndërkombëtare dhe Unionin Evropian.

3. QËLLIMET E MËSIMIT NË KLASËN VIII

Nxënësi/nxënësja:

- të njohë ndërtimin e identitetit të vet dhe të trajtojë në mënyrë kritike ndikimet e ndryshme në formimin e mendimeve të dikujt;
- t'i pranojë vlerat e shoqërisë demokratike dhe rolin e vet në shoqërinë qytetare;
- të ketë ndjenjë të përkatësisë ndaj bashkësisë dhe t'i njohë përfitimet e jetesës në shoqërinë multikulturore;
- t'i njohë vlerat e shoqërisë demokratike dhe të theksojë nevojën e ndërlidhjes për të drejtat e njeriut me përgjegjësitë;
- t'i njohë dhe t'i pranojë dallimet në shoqërinë demokratike dhe nevojën për tolerancë reciproke;
- të njohë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të theksojë nevojën për pjesëmarrje aktive në mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- të njohë rëndësinë dhe ndikimin e mediave në zhvillimin e shoqërisë demokratike;
- të kuptojë rolin e religjionit në shoqërinë demokratike dhe nevojën e tolerancës fetare në shoqërinë multikulturore;
- të theksojë rëndësinë e kulturës dhe artit në përditshmëri dhe në zhvillimin e shoqërisë qytetare;
- të kuptojë rregullimin e shtetit dhe nevojën për pjesëmarrje aktive të qytetarit në shtetin demokratik;
- të përshkruajë se si fitohet autoriteti legjitim në funksion të qytetarëve në shoqëri;
- të kuptojë rolin e organizatave ndërkombëtare në botën bashkëkohore dhe procesin e globalizimit;
- të kuptojë nevojën dhe t'i theksojë përfitimet nga pjesëmarrja e Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare.

4. QËLLIMET KONKRETE

Tema I: Paraqitja e vetes si qytetar – 4 orë

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të kuptojë konceptin identitet, si formohet identiteti dhe të njohë karakteristikat e identitetit 	<p>Identiteti personal, Identiteti grupor.</p>	<p>Identitet (identitet personal, identitet grupor).</p>	<p>Krijimi i hartave ideore me temë: <i>Identiteti (kush jam unë)</i>.</p> <p>Kush dhe si ndikon në identitetin tim.</p> <p>Debat rreth temës: <i>Identiteti dhe faktorët që ndikojnë në identitetin, të shprehurit e identitetit</i>.</p> <p>Lojë në role/simulimet: Më lejoni të prezantoj veten time.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja është i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> të numërojë lloje të identitetit dhe të sqarojë se përmes ndërtimit të identitetit ndikojnë reciprokisht faktorët e përditshmërisë (psh: përvoja, familja, kultura e të jetuarit dhe grupet e ndryshme sociale, modele); në mënyrë kritike të analizojë ndikimet e ndryshme në formimin e mendimeve, sjelljeve, veshmbathjes të dikujt dhe ngjashëm; të diskutojë lirshëm për identitetin e vet.
<ul style="list-style-type: none"> t'i njohë dhe t'i vlerësojë karakteristikat personale, t'i ndërlidhë karakteristikat personale me sukseset dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet në situata të caktuara; të sqarojë ku janë ngjashmëritë dhe dallimet me të tjerët dhe të ndërlidhë sjelljen personale me sjelljen e individëve ose grupeve tjera. 	<p>Karakteristikat personale dhe grupore.</p>	<p>Ngjashmëritë, dallimet, karakteristikat.</p>	<p>Numërimi i vetive personale sipas këndvështrimit të secilit nxënës.</p> <p>Diagrami i Venit.</p> <p>Hulumtimi/ anketë për përkatësinë e grupeve të ndryshme, për karakteristikat që i vlerësojnë nxënësit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> të njeh ngjashmëritë dhe dallimet ose grupet të cilave iu përket; në situata konkrete t'i analizojë dhe t'i vlerësojë karakteristikat personale; t'i sqarojë dhe t'i ndërlidhë karakteristikat personale me sjelljen në kontekste të ndryshme qytetare.

Tema II: Bashkëpunimi dhe lidhshmëria në shoqërinë qytetare – 6 orë				
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> t'i kuptojë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet njerëzve në shoqëri dhe t'i respektojë vlerat kulturore e të tjera 	Ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet njerëzve në shoqërinë qytetare.	Pranimi, respektimi, dallimet.	Luajtje në roli. Punë në grupe. Teknikat: <i>Diagrami i Venit, rrushit, prizëm.</i> Punë individuale – Fletë pune „Relacionet“.	<p>Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> përshkruajë dallimet dhe të njuh vlerat kulturore që janë të rëndësishme për bashkëpunim; njuh përfitimet nga respektimi i dallimeve;
<ul style="list-style-type: none"> T'i kuptojë raportet e anëtarëve në bashkësi dhe t'i kuptojë përfitimet nga jetesa në bashkësi; t'i kuptojë përfitimet nga përfshierja dhe kontributi për përmirësimin e bashkësisë. 	Përkatësia ndaj bashkësisë.	Bashkësia, Raportet, individët, vullnetarizmi.	Punë individuale. Trajton një ngjarje në të cilën bëhet fjalë për kontributin ndaj bashkësisë.	<ul style="list-style-type: none"> njuh elementet ndërlidhëse të jetës së bashkësisë; i analizon raportet e anëtarëve në bashkësi dhe kontributet e tyre në të; njuh dhe të planifikojë aktivitete që kontribuojnë në përmirësimin e raporteve në bashkësi; njuh aktivitetet që mund t'i bëjë për të përmirësuar bashkësinë.
<ul style="list-style-type: none"> Të dijë se secili mund të ketë qëndrim dhe pikëpamje të ndryshme dhe kjo duhet të respektohet; të kuptojë bashkëjetesën dhe bashkësinë e përkatësive; t'i njuh dallimet kulturore si vlera dhe të dijë se ato janë vlera të shoqërisë multikulturore. 	Bashkëpunimi dhe ndërlidhjet në bashkësi.	Tolerancë, bashkëjetesë, bashkësi, multikulturë.	Punë në çifte. Diskutimi në temë: <i>Dallimet kulturore.</i>	<ul style="list-style-type: none"> toleron pikëpamje të ndryshme dhe i sqaron por edhe i mbron qëndrimet e veta; bën dallimin ndërmjet bashkëjetesës dhe bashkësisë në bashkësi (shoqëri); arsyeton se respektimi i kulturave të ndryshme është i

Tema II: Bashkëpunimi dhe lidhshmëria në shoqërinë qytetare – 6 orë				
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
				<p>domosdoshëm për interaksionin multikulturor;</p> <ul style="list-style-type: none"> – numëron dallimet e kulturave që janë të rëndësishme të respektohen në një mjedis multikulturor; – jep shembuj të aktiviteteve të cilat i përforcojnë raportet e mjedisit multikulturor; – merr pjesë në aktivitete që i përforcojnë raportet ndërmjet kulturave të ndryshme.

Tema III: Qytetari dhe shoqëria – 10 orë				
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> – t'i sqarojë rolet e ndryshme dhe sjelljet e qytetarëve në shoqëri; – t'i analizojë vlerat e shoqërisë demokratike dhe roli i tij në të. 	Roli i qytetarit në shoqëri.	Vlera.	<p>Debat rreth temës: <i>Vlerat e shoqërisë demokratike.</i></p> <p>Përgatitë T-tabelë: <i>Ndërlidhja e roleve të qytetarit në shoqëri dhe sjellja e qytetarëve në shembuj konkret.</i></p> <p>Diskutim për pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete të ndryshme (përdoret shkalla e Roxher Hart).</p>	<p>Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – përshkruan rolet dhe sjelljet dhe në mënyrë të argumentuar të diskutojë për rolet e ndryshme dhe sjelljet e qytetarëve në përditshmëri; – i njeh vlerat e shoqërisë demokratike në situata konkrete dhe angazhohet për respektimin e tyre në mjedisin e vet; – jep ide për nismën e aktiviteteve për përmirësimin e jetës në bashkësi (aktivitete

Tema III: Qytetari dhe shoqëria – 10 orë

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
<ul style="list-style-type: none"> – Të sqarojë dukuritë dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm në zhvillimin e të drejtave të njeriut; – Të vlerësojë si të drejtat e njeriut e avancojnë shoqërinë demokratike dhe të angazhohet për avancimin e tyre. 	<p>Zhvillimi i të drejtave të njeriut.</p>	<p>Deklarata, Konventa, Të drejtat</p>	<p>Analizon dokumente dhe tekste në të cilat përshkruhet zhvillimi i të drejtave të njeriut. (Deklarata universale, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve).</p> <p>Diskutim rreth temës: <i>Në çfarë mënyre të drejtat e njeriut mbrohen, avancohen dhe zhvillohen.</i></p>	<p>ekologjike dhe humanitare, iniciativa qytetare).</p> <ul style="list-style-type: none"> – e përshkruan zhvillimin e të drejtave të njeriut; – në mënyrë kritike të analizojë dhe të diskutojë për shkeljen e të drejtave të njeriut; – thekson shembuj konkret pozitiv ku janë të mbrojtura të drejtat e njeriut.
<ul style="list-style-type: none"> – Të dallojë llojet e të drejtave të njeriut (qytetare, politike, ekonomike-sociale, kulturore, ekologjike...); – Të analizojë të drejtat qytetare dhe përgjegjësitë në shoqëri. 	<p>Llojet e të drejtave dhe përgjegjësitë.</p>	<p>Përgjegjësitë, të drejtat qytetare, politike, ekonomike-sociale, kulturore, ekologjike.</p>	<p>Përpilimi i një harte konceptuale në të cilën të drejtat ndërlidhen me përgjegjësitë.</p> <p>Nxënësit luajnë në role: <i>të drejtat dhe përgjegjësitë.</i></p> <p>Përpilimi i posterave me mesazhe mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.</p> <p>Trajtimi i një ngjarje në të cilën flitet për mbrojtjen e mjedisit jetësor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – i njeh të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në shoqërinë qytetare; – njeh dhe të diskutojë për raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe mospërgjegjësisë qytetare; – jep shembuj individual për respektimin e të drejtave në mjedisin e tij në situata konkrete.

Tema III: Qytetari dhe shoqëria – 10 orë

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
			Hulumtimi dhe identifikimi i problemit nga mjedisi i tij dhe zgjidhja e problemit.	
<ul style="list-style-type: none"> – T’i dijë të drejtat e fëmijëve dhe të sqarojë nevojën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. 	Të drejtat e fëmijës.	Avokati i Popullit (Ombudsmani), të drejtat specifike të fëmijëve.	<p>Përpilimi i një posteri me të drejtat e fëmijës.</p> <p>Analiza e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe përpilimi i rang-listës për të drejtat e fëmijëve sipas pikëpamjeve individuale të nxënësve.</p> <p>Vizitë në zyrën e Avokatit të popullit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – numëron të drejta të caktuara të fëmijëve nga Konventa; – i ndërlidhë të drejtat e fëmijëve në shkollë dhe në shtëpi me përgjegjësitë e tyre; – thekson shembuj të shkeljes të së drejtave të fëmijëve; – propozon aktivitete në organet e bashkësisë së nxënësve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
<ul style="list-style-type: none"> – e sqaron rëndësinë e koncepteve: diskriminimi, stereotipet dhe paragjykimet; – nxitet të kontribuojë në pengimin e diskriminimit, stereotipeve dhe paragjytimeve. 	Diskriminimi, stereotipet dhe paragjykimet	Diskriminimi, Stereotipet, paragjykimet.	Luan në role në shoqërinë e grupeve të marginalizuara dhe individëve të cilët janë të ekspozuar ndaj diskriminimit.	<ul style="list-style-type: none"> – njeh diskriminimin, stereotipet dhe paragjykimet përmes rasteve konkrete (mediat, fjalimet, tekstet, librat shkollore etj.); – reagon me dënim në situata konkrete në të cilat dikush është i ekspozuar ndaj diskriminimit.

Tema IV: Religjioni, arti dhe mediat në shoqërinë qytetare – 6 orë				
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> – ta sqarojë rolin e religjionit dhe bashkësive fetare në shoqërinë qytetare; – të bëj dallim ndërmjet pjestarëve të bashkësive të specifikave të ndryshme fetare; – të bëj dallim ndërmjet shundit/kiçit dhe artit; – ta sqarojë rolin e mediave në krijimin e mendimit publik në shoqëri; – të bëj krahasim ndërmjet llojeve të ndryshme të mediave nga aspekti i mënyrës së informimit. 	Religjioni në shoqëri	Religjioni, Bashkësitë fetare	<p>Përpilimi i aktiviteteve projektuese dhe vizitat e objekteve fetare.</p> <p>Diskutimi për religjionin në jetën e përditshme (ngjashmëritë, dallimet, pranimi, stereotipet etj)</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të: – t’i dijë specifikat e bashkësive të ndryshme të religjioneve nga mjedisi i vetë; – komunikon me pjestarë të religjioneve të ndryshme; – merr pjesë aktive në diskutime të ndërlidhura me rolin e religjionit në shoqëritë moderne; – demonstroi shembuj të pranimi të religjionit tjetër;
<ul style="list-style-type: none"> - ta sqarojë rolin e artit, artistit dhe ndikimin e veprave artistike në ndërtimin e shoqërisë qytetare; - të bëj dallim ndërmjet shundit/kiçit dhe artit. 	Arti i shoqërisë qytetare.	Arti, shundi, kiçi.	<p>Puna në grupe, hulumtimi me temë shundi/kiçi dhe arti.</p> <p>Analiza e veprës artistike nga aspekti i ndikimit të tyre mbi zhvillimin e shoqërisë qytetare (kënga, ilustrimi, ndërtimi, përmendore).</p>	<ul style="list-style-type: none"> – e prezanton rolin e artit në shoqërinë qytetare përmes shembujve konkret; – e hulumton raportin e qytetarëve ndaj artit në shoqërinë qytetare përmes përpunimit të projektit; – njeh shundin/kiçin në veprat konkrete artistike;

Tema IV: Religjioni, arti dhe mediat në shoqërinë qytetare – 6 orë				
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
<ul style="list-style-type: none"> - ta sqarojë rolin e mediave në krijimin e mendimit publik në shoqëri; - të bëj krahasim ndërmjet llojeve të ndryshme të mediave nga aspekti i mënyrës së informimit. 	Mediat në shoqërinë demokratike.	Mediat, Mas - mediat, Përmbajtjet mediatike (gënjeshtra dhe të vërteta), demanti, fakti	Puna në grupe. Diskutimi (për rolet pozitive dhe negative të mediave të reja). Analiza e mediave. Puna individuale. Luajtja në role – sociodrama.	<ul style="list-style-type: none"> - dallon rolin e mediave në krijimin e mendimit publik përmes shembujve konkret; - analizon mundësi për zbatimin e mediave bashkëkohore në mjedisin e vetë (revistë shkollore, radio shkollore, internet portal, blog, video – blog) në drejtim të përparimit të vlerave qytetare.

Tema V: Qytetari dhe shteti – 6 orë				
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
Nxënësi/nxënësja: <ul style="list-style-type: none"> – të bëj dallim ndërmjet shtetit dhe shoqërisë, – të krahasojë lloje të ndryshme të rregullimit shtetëror, – ta sqarojë nevojën e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në shoqëri, përkundër vëzhgimit pasiv të proceseve dhe ngjarjeve. 	Rregullimi shtetëror dhe shoqëror (llojet e rregullimit shtetëror)	Rregullimi shtetëror, Shoqëria qytetare.	Diagrami i Venit për konceptet shteti dhe shoqëria. Analiza e tekstit. <i>Ese: Pjesëmarrja aktive e qytetarit e bën fuqi lëvizëse në shoqëri.</i>	<ul style="list-style-type: none"> – Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të: – definojnë nocionet shteti dhe shoqëria; – i theksojnë karakteristikat themelore të shoqërisë qytetare; – dallon lloje të ndryshme të rregullimit shtetëror; – propozon ide konkrete dhe aktivitetet se si qytetari ta përparojë shoqërinë;

<ul style="list-style-type: none"> – të sqarojë se çka paraqet pushteti, – të përshkruaj se si arrihet pushteti legjitim në shtetin demokratik, 	<p>Pushteti në funksion të qytetarëve.</p>	<p>Pushteti, fuqia, pushteti legjitim.</p>	<p>Luajtja në role me tekste të përpiluara nga mësime të mësimdhënës.</p> <p>Simulimi i zgjedhjeve.</p> <p>Diskutimi i udhëzuar (strukturuar).</p>	<ul style="list-style-type: none"> – diskuton për burime të fuqisë në shoqëri dhe mënyrat e mbrojtjes së interesave të të gjithë banorëve; – promovon mënyra demokratike të sundimit përmes pushtetit të zgjedhur legjitim, – reagon në keqpërdorime të llojeve të ndryshme të fuqisë (për shembull: nxënës, mësime të mësimdhënës, bashkëpunëtor profesional),
<ul style="list-style-type: none"> – të sqarojë se si është i organizuar pushteti në RM-së, – t’i ndërlidh funksionet e pushtetit të parapara në Kushtetutën e RM me institucionet kompetente. 	<p>Si është i organizuar pushteti në RM.</p>	<p>Kushtetutë, Kuvendi, Qeveria, Kryetari, Gjyqi, Avokati i popullit, Njësia e vetëqeverisjes lokale (komuna).</p>	<p>Hulumtimi në tre grupe për ndarjen e pushtetit sipas Kushtetutës së RM-së dhe prezantimi i rezultateve të hulumtimit.</p> <p>Kuizi: Si është i organizuar pushteti në RM-së.</p> <p>Vizita e organizuar sipas zgjedhjes së nxënësve dhe mësime të mësimdhënës (Kuvendi, Qeveria, Kryetari i RM-së, gjyqi)</p>	<ul style="list-style-type: none"> – zbaton Kushtetutën e RM-së që ta analizojë ndarjen e pushtetit në ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqsor nga aspekti i kufizimeve të fuqisë, – e ndërlidh veprimtarinë e Avokatit të popullit me funksionimin e institucioneve në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet.

Tema VI: Qytetari dhe bota – 4 orë

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat	Rezultatet nga mësimi
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> – ta sqarojë rolin e organizatave ndërkombëtare dhe funksionimin e tyre; – t’i analizojë përfitimet e pjesëmarrjes së shteteve në organizatat ndërkombëtare; – të hulumtojë për rolin e organizatave ndërkombëtare në krahasim me të drejtat e fëmijës. 	Organizatave ndërkombëtare.	Bashkësia ndërkombëtare, globalizimi, OKB, UNICEF, OBSE, NATO, Kryqi i Kuq dhe Gjysmëhëna e Kuqe.	<p>Diskutimi me temë përmes <i>stuhi ideshë</i>, organizatat botërore ndërkombëtare). Puna në grupe (formohen 4 grupe me së paku nga 4 nxënës; për secilin grup u jepet material pune; mandej formohen grupe të reja në të cilët do të ketë nga një prej secilit nga grupet paraprake dhe do të ketë rol të ekspertit për materialin që e ka punuar në grupin paraprak).</p> <p><i>Pyetje ese:</i> <i>Sfida dhe përfitime për qytetarët nga puna e organizatave ndërkombëtare.</i></p>	<p>Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – dallojë përfitimet e pjesëmarrjes në organizatat ndërkombëtare në krahasim me të drejtat e njeriut, paqjen dhe zhvillimin e vlerave demokratike në botë; – thekson shembuj konkret apo aktivitete me të cilat do të ishit mbrojtur të drejtat e fëmijës me dokumentet ndërkombëtare,
<ul style="list-style-type: none"> – ta sqarojë rëndësinë e pjesëmarrjes së RM në organizatat ndërkombëtare (për shembull OKB, OBSE, NATO, Kryqi i Kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe etj) – t’i dallojë përfitimet konkrete për shkollën dhe nxënësin nga aktivitetet e inicuar ose 	Republika e Maqedonisë dhe organizatat ndërkombëtare.	Karta e OKB, Partneriteti për paqë, Gjyqi ndërkombëtar i së drejtës.	<p>Teknika e <i>rrushit</i></p> <p>Puna me grupe, Hulumtimi i obligimeve dhe përfitimeve të RM-së nga pjesëmarrja dhe anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – thekson përfitime konkrete nga veprimtaria e organizatës ndërkombëtare, – numëron shembuj të pjesëmarrjes dhe kontributit të RM-së, në misionet e organizuara paqësore të organizatave ndërkombëtare.

<p>të përkrahura nga organizatat ndërkombëtare.</p>			<p>Diskutimi me temë: <i>Vallë pse për apo pse kundër pjesëmarrjes së RM-së në organizatat ndërkombëtare.</i></p> <p>Pyetje eseje: <i>Përfitimet për bashkësinë tanë nga pjesëmarrja e RM-së në organizatat ndërkombëtare.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - numëron shembuj të pjesëmarrjes dhe kontributit të RM-së, në misionet paqësore të organizuara nga organizatat ndërkombëtare. - thekson përfitimet e bashkësisë apo shkollës nga aktivitetet e realizuara që janë të inicuar apo përkrahura nga organizatat ndërkombëtare.
---	--	--	--	--

5. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

Programi mësimor është përpiluar në pajtim me karakteristikat zhvillimore të nxënësve në klasën VIII në arsimin fillor nëntëvjeçar. Përfshin elemente didaktike të cilat janë karakteristike për mësimin në shkollën fillore bashkëkohore dhe me maturi psikofizike të nxënësit. Materiali mësimor është i sistematizuar në mënyrë sistematike në bazë të shkencës bazike me teorinë e tyre, metodat hulumtuese dhe logjika e përfundimit.

Mësimdhënësit e Arsimit qytetar planifikimet dhe përgatitjet e tyre për mësimin duhet t'i zhvillojnë në bazë të qëllimeve dhe rezultateve të pritura sipas temave dhe përmbajtjeve mësimore me zgjedhje adekuate të metodave dhe aktiviteteve në procesin mësimor. Planifikimi përfshin detyra që duhet të kryhen në kohë të caktuar për realizimin e qëllimeve të parashtruara dhe rezultatet e pritura, por edhe mënyrat për kontrollimin dhe vlerësimin e rezultateve të arritura. Me planifikimin shmangët mosorganizimi i procesit edukativo-arsimor, ndërsa pika fillestare për përpilimin e planifikimit është refleksioni që nënkupton se planifikimi si sitem i punës vazhdimisht duhet të përparojë.

Programi mësimor për klasën VIII ofron gjashtë tema mësimore zhvillimore që mësohen edhe në klasën IX, për të cilët rekomandohet të organizohet mësimi bashkëkohor interaktiv.

Për shkak të specifikës së lëndës mësimore dhe lidhjes së tyre me jetën e përditshme të nxënësve në mësimin duhet të ketë kujdes për përshtatjen e përmbajtjeve programore dhe angazhimin e shoqërisë qytetare demokratike me metodat që përdoren dhe klima e përgjithshme në orën (përgjegjshmëri, bashkëpunim, respekt, demokraci etj). Përkatësisht, është e domosdoshme që nxënësit të aftësohen t'i zbatojnë njohuritë, të ndërtojnë qëndrimet, interesat dhe mendimet e tyre që do të kontribuojnë të jenë aktiv, ta pasurojnë pjesëmarrjen e tyre të nxënësit dhe mandej ta avancojnë shoqërinë qytetare si qytetarë të moshës madhore, ndërsa ajo më me sukses arrihet përmes përvojës individuale.

Programi mësimor në arsim qytetar me sukses mund të realizohet në mësimin shkollor me zbatimin e metodave dhe aktiviteteve për nxitjen e mësimin të përthelluar e të kuptuarit, kooperimit, punës në grupe dhe hulumtimin e pavarur si dhe zbulimin e njohurive. Mësimdhënësit e arsimit qytetar duhet të kontribuojnë për krijimin e klimës demokratike, përmes aktiviteteve hulumtuese, punëtorive projektuese, nxënësit ta shprehin mendimin e tyre, të pranojnë vlera, të edukohen në frymën e bashkëpunimit, humanitetit, komunikimit të padhunshëm, mosdiskriminimi dhe respektimi i ngjashmërive.

Mësimi në arsimin qytetar planifikohet, organizohet dhe realizohet rregullisht me fondin e paraparë të orëve që është i caktuar me planin mësimor. Nxënësit në mësim vlerësohen me notë numerike që ka ndikim në suksesin e tërësishëm.

Rekomandimet për përdorimin e fondit vjetor të orëve (planifikimi orientues për orët mësimore sipas temave dhe përmbajtjeve mësimore).

Rekomandimet për fondin vjetor të orëve janë dhënë si orientim, së bashku me qëllimet konkrete, rezultatet e pritura dhe temat/përmbajtjet, me se nuk duhet ta kufizojë shpërndarjen e tyre sipas nevojave gjatë realizimit. Mbjajtjen më ndryshe të orëve duhet ta vlerësojë mësimdhënësi lëndor sipas arritjeve të nxënësve të tyre, përkatësisht sipas ndryshimeve në cilësinë dhe aftësitë që ata i arrijnë.

Rekomandohet përdorimi i mjeteve të caktuara vijuese:

- libër i lëndës, lejuar nga ministri;
- burime tjera për mësim në mjedisin e drejtëpërdrejtë, vizita e institucioneve të specializuara si dhe bashkëpunimi me persona profesional;
- enciklopedi, fjalor, revista, shtypi ditor, aktet ligjore, dokumentet ndërkombëtare;
- internet, softuerë të njohur dhe përmbajtje digjitale;
- mjete audiovizuale dhe mjete tjera adekuate me lëndën.

6. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Gjatë mëimit rregullisht ndiqen dhe vlerësohen të arriturat e nxënësve. Përmblihen treguesit për të arriturat e qëllimeve të parashtruara përmes matjes së rezultateve të arritura. Përveç kësaj ndiqen aktivitetet për mësim, ndërtimi i qëllimeve të veta dhe të menduarit për çështje të caktuara nga materiali mësimor, motivimi për mësim, bashkëpunimi me tjerët, angazhimi i nxënësve në bashkësi. Për këtë arsye nxënësit fitojnë informata reciproke dhe udhëzime për përmirësimin e punës dhe të arriturave të tyre. Përdoren metoda dhe teknika të ndryshme për vlerësimin formativ dhe sumativ.

Nxënësit duhet të informohen paraprakisht për kriteret e vlerësimit sumativ numerik. Aty nuk duhet të përfshihen qëndrimet e nxënësve për çështje të caktuara shoqërore.

Rregullisht bëhet informimi i secilit nxënës, si i prindërve për të arriturat e nxënësve. Vlerësimi është pjesë përbërëse e planifikimit të mësimdhënësit për mësimin dhe nxënien.

7. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Sa i përket kushteve hapësinore, programi bazohet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe mjete mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar përcaktuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 07-1830/1 prej 28.2.2008.

8. NORMATIVI I KUADRIT MËSIMOR

Mësimin në lëndën mësimore *Arsimi qytetar* e realizon mësimdhënësi me studime të mbaruara për sociologji, histori apo studime për filozofi.

9. FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Data e fillimit: **01.09.2018**

10. NËNSHKRIMI DHE DATA E PËRCAKTIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Programi mësimor në *Arsimin qytetar* për klasën VIII në arsimin fillor nëntëvjeçar, me propozim të Byrosë së zhvillimit të arsimit e përcaktoi ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Nr. i ark. **12-8342/2**

MINISTËR

18.07.2018 година

Dr. Arbër Ademi

Përpiloi: Grupi i punës nr. 02-56/1 më 25.4.2018

Koordinues: mr.Oliver Stanojoski

Kontrolloji: Trajçe Gjorgjievski, udhëheqës njësie

Lejoi: mr. Mitko Çeshllarov, udhëheqës sektori